



kur t'i kërkoni Allahut, kërkoni prej Tij Firdeusin!”

Ubade ibn Samiti (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Në Xhenet ka njëqind shkallë; distanca mes çdo dy shkallëve është si distanca mes qiellit dhe Tokës. Më e larta prej tyre në gradë është Firdeusi, prej të cilit burojnë katër lumenjtë e Xhenetit, dhe mbi të është Arshi (Froni Hyjnor). Prandaj, kur t'i kërkoni Allahut, kërkoni prej Tij Firdeusin!”

[Sahih] [Transmeton Tirmidhiu]

Profeti ﷺ ka njoftuar se në Xhenetin e botës tjetër ka njëqind shkallë dhe grada. Distanca mes çdo dy shkallëve është si distanca mes qiellit dhe Tokës. Më e larta prej këtyre xheneve është Firdeusi, prej të cilit burojnë katër lumenjtë e Xhenetit, dhe mbi Firdeus është Arshi (Froni Hyjnor). Prandaj, kur t'i kërkoni Allahut, kërkoni prej Tij Firdeusin, sepse ai është mbi të gjitha xhenetet e tjera.

<https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/65188>

النجاة الخيرية
ALNAJAT CHARITY

